



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
AGJENCIA PËR MEDIA DHE INFORMIM

Nr. 516/1 Prot.

Tiranë, më 29. 9 2025

**RAPORTI I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË BUXHETIT
PËR AGJENCINË PËR MEDIA DHE INFORMIM
Periudha e raportimit : Janar – Gusht 2025**

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, mbështetur në udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr. 2 datë 06.02.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” si dhe Udhëzimit nr. 14, datë, 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore”, po ju paraqesim raportin e monitorimit të buxhetit për periudhën e 8 -mujorit për vitin 2025.

Agjencia për Media dhe Informim, për vitin 2025 i është akorduar fondi buxhetor, sipas programit të miratuar, konkretisht:

1150 Shërbime të tjera

Programi konsiston në sigurimin dhe transparencën në lidhje me politikat, aktivitetet, projektet, eventet si dhe qellimin, objektivat, risitë apo problematikat që zgjidhen nëpërmjet akteve të Këshillit të Ministrave dhe të akteve të tjera të ministrave dhe çdo institucioni të administratës shtetërore.

1. Realizimi i Produktit të Parashikuar për vitin 2025

Produkti i Agjencisë për Media dhe Informim është Komunikimi dhe Informimi Mediatik (Kodi 98704AN). Ky produkt ka një buxhet të planifikuar për 8 - mujorin në vlerën 103,900 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 75,166 mijë lekë, që përbën 72 % të planifikimit..

2. Përmbledhje e buxhetit të miratuar

(Në 000/Lekë)

Zëri buxhetor	Buxheti i miratuar	Buxheti i rishikuar	Plan Janar - Gusht 2025	Fakti Janar - Gusht 2025
Shpenzime Totale	150,112	150,112	103,900	75,166

Buxheti fillestar për vitin 2025, i planifikuar për këtë program, është 150,112 (në 000/Lekë).

Plani për periudhën Janar - Gusht 2025 është 103,900 112 (në 000/Lekë).

Realizimi faktik për periudhën Janar – Gusht 2025 është 75,166 (në 000/Lekë), që përbën 72 % të planit 8 - mujor.

Ky program konsiston në mbështetjen buxhetore të shërbimeve të përgjithshme të Agjencisë për Media dhe Informim, dhe përmirësimin e infrastrukturës së saj.

3. Realizimi i shpenzimeve Janar - Gusht për këtë program, sipas zërave kryesorë

(Në 000/Lekë)

Zëri buxhetor	Buxheti i miratuar	Buxheti i rishikuar	Buxheti i çelur 8-mujorit	Realizimi i 8-mujorit	Përqindja e realizimit (%)
Paga	114,562	114,562	78,700	62,777	80 %
Sigurime Shoqërore	19,150	19,150	12,800	10,152	80 %

Mallra dhe shërbime të tjera	15,000	15,000	11,000	2,071	19 %
Transferta për buxhet Familjar dhe Individ	400	400	400	167	63 %
Investime	1,000	1,000	1,000	0	0
TOTALI	150,112	150,112	103,900	75,166	72 %

4. Përshkrimi i Shpenzimeve dhe Produktit të Programit.

Buxheti për 8 - mujorin është realizuar në masën 72 % ndaj planit total.

- Personeli: Realizimi në nivel 80 % për shkak të mosplotësimit të strukture.
- Shpenzime për Sigurime Shoqërore: Realizimi në nivel 80 % për shkak të mosplotësimit të strukture.
- Shpenzimet operative: Realizimi në nivel 19 % për shkak të planifikimit të blerjeve të vogla në periudhën Tetor – Nëntor 2025.
- Trarferta për buxhet familjar dhe individual: Realizimi në nivel 63 % për shkak të mosplotësimit të strukture.
- Investime: Për realizimin e tij është ngritur komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe caktimin e fondit limit dhe pritjet të vijohet me shpalljen e procedurës.

Ky program përfshin financimin për pagat e punonjësve, si dhe shpenzime për përmirësimin e kushteve të punës dhe rritjen e efektivitetit të burimeve njerëzore, përmes trajnimeve dhe shpenzimeve të tjera të nevojshme (energji, uje, posta, karburant, telefon, etj.).

Këto shpenzime janë të lidhura ngushtë me përmbushjen e detyrave të Agjencisë për Media dhe Informim dhe përmirësimin e kapaciteteve menaxhuese dhe implementuese të saj.

Numri i punonjësve buxhetore të miratuar sipas planit vjetor është 69 dhe numri faktik është 62 nga ai i planifikuari.

5. Tregues me bazë gjinore

Numri i vajzave dhe grave në total është 44, të cilat përbëjnë 71 % të organikës, 5 janë në nivel drejtues.

Konkluzione:

Nga realizimi i shpenzimeve për periudhën Janar – Gusht 2025, mund të konkludohet se objektivi i politikës për menaxhimin efektiv të buxhetit dhe zbatimin e suksesshëm të programit është realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

MANJOLA HASA

